



VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT PËR SHQYRTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Data e miratimit: 10 janar 2017

Numri i lëndës: 2014-37

Y.B.

kundër

EULEX-it Kosovë

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 janar 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 19 TETOR 2016

1. Me 19 tetor 2016, Paneli ka marrë vendimin pasues rreth ankesës së paraqitur nga Y.B. me 29 shtator 2014:

“Paneli, njëzëri:

1. Shpall ankesat, sipas neneve 6, 10 dhe 11 të Konventës, të papranueshme, pasi janë qartazi të pabazuar;
2. Gjen një shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

dhe

Deklaron

se në bazë të gjetjeve të fakteve dhe ligjit të mësipërm, Paneli gjen të përshtatshme t’i bëjë rekomandime ShM-së, dhe

REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE:

- ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- ShM-ja duhet t’i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbej që të informohen prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të detyrimit të tyre për t’i përfshirë viktimat në hetimet e tyre dhe për të ofruar arsye të duhura rreth ndërprerjes së ndonjë hetimi në ndonjë rast të veçantë.”

II. INFORMATA NGA ShM-ja e EULEX-it

2. Me 28 nëntor 2016, ShM-ja ka deklaruar se në lidhje me rekomandimin e dytë të Panelit, ajo ka siguruar që një kopje e vendimit të Panelit t’i ofrohej prokurorëve të EULEX-it.

III. INFORMATA NGA ANKUESI

3. Me 8 dhjetor 2016 ankuesit iu është dhënë një kopje e letrës nga ShM-ja që ishte e datës 28 nëntor 2016 lidhur me veprimin e ndërmarrë nga ShM-ja në zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Ankuesi nuk i ishte përgjigjur kësaj letre e as nuk kishte komentuar mbi veprimet e ndërmarra nga ShM-ja.

IV. VLERËSIMI NGA PANELI

4. Paneli vëren hapat e ndërmarra nga ShM-ja për t'i zbatuar rekomandimet e tij,
5. Megjithatë, Paneli më tej thekson se ShM-ja nuk ka bërë deklaratë, të ndonjë forme, për të pranuar se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ishin ngarkuar veprimeve të EULEX-it Kosovë.
6. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja lidhur me zbatimin e rekomandimeve,

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë rast vetëm pjesërisht,

Vendos të mbyllur shqyrtimin e këtij rasti.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese